Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/1008

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Isa Hasani - Kryetar duke vendosur sipas ankesës së OE "Gani B. Krasniqi B.I." kunder njoftimit mbi vendimin e AK lidhur me aktivitetin e prokurimit "Servisimi dhe mirembajtja e veturave zyrtare te MMPHI-se (ish MMPH)" me nr. të prokurimit: "210-23-10358-2-1-1" inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapesinor më 19/03/2024, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e "Gani B. Krasniqi B.I." me nr. 2023/1008 , e datës 12.12.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare te MMPHI-se (ish MMPH)" me nr. të prokurimit: "210-23-10358-2-1-1" iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) –Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor.

2.Mbetet ne fuqi, Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues, – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit.

3.Urdhërohet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës

Arsyetim

Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 28.09.2023 Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare te MMPHI-se (ish MMPH)" me nr. të prokurimit: "210-23-10358-2-1-1".

Ndërsa me datën 04.12.2023 AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontrate "Bastri Ademi "B.I"

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 200,000.00 €.

Me 07.12.2023, OE "Gani B. Krasniqi B.I." ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 11.12.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 12.12.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "Gani B. Krasniqi B.I." me nr. 1008/23 lidhur me aktivitetin "Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare te MMPHI-se (ish MMPH)" me nr. të prokurimit: "210-23-10358-2-1-1".

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Gani B. Krasniqi B.I." janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I) : Autoriteti Kontraktues-(AK) Ministria e Mjedisit, Planifikimi Hapësinor dhe Infrastrukturës e ka rekomanduar për kontratë një Operator ekonomik i cili është i papërgjegjshëm për faktin se i njëjti nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, përkatësisht Kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2: Kapaciteti teknik dhe profesional Kërkesa nr.3: 3.Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit a. Vinça Hidraulik për ngritje te automjeteve minimum 5 copë b. pajisje për mbushjen e klimave minimum 1 copë c. Pajisje për diagnoztifikimin e automjeteve minimum 1 copë. d. Automjet për transportimin e automjeteve minimumi 1 copë. Dëshmia e kërkuar dokumentare: 3. Dëshmi me foto apo ndonjë dokument tjetër dëshmues (apo te marrjes me qira) te mjeteve duhet te jene - Deklaratat unike doganore - DUD, foto apo ndonjë fature për blerjen e tyre, ndërsa për automjetet qe janë ne lëvizje për bartjen e automjeteve ato te dëshmohen me libreza te qarkullimit te automjeteve valide. Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar dëshmi te domosdoshme për te realizuar projektin në fjalë, për piken d. Automjet për transportimin e automjeteve nuk ka ofruar automjeti komfor standardeve te automjeteve te kërkuar nga autoriteti kontraktues MMPHI-së. Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka prezantuar një kamion Automjet transportues (kamion) me dy dyer, ngjyr e kaltër të prodhuesit IVECO, Tipit 50.8.1-B, me Numër identifikues i automjetit ZCFA5070002161910, numër te rexhistrimit, tabelave: 01-891-EA, viti i prodhimit 1984, me Peshe maksimale e ngarkesës së lejuar 3510 KG. Të oferta financiare Pjesa II. Lista e Automjeteve, Specifikacion Teknik dhe Çmimeve- Mirëmbajtja dhe Servisimi i Veturave, Pjesa II. Lista e çmimeve, Autoriteti Kontraktues (AK-ja) ka prezantuar të gjitha tipat e automjeteve te cilat do te servisohen, duke cekur Tipin e automjetit, prodhuesin e automjetit, vitin e prodhimit dhe duke ja cekur Kapacitete në cm3. Të specifikimeve teknike dhe ofertës financiare – Pjesa II. Të Lista e çmimeve, është i përfshirë edhe automjetit i prodhuesit Tojota 3.0/4.8 cm3, viti 1999-2008 (7

Vetura), i cili është i përfshirë ne ofertën financiare, dhe që gjatë ekzekutimit te kontratës do te servisohet, i njëjti automjet është në pronësi te AK-së Ministria e Mjedisit, Planifikimi Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Pretendimi i dytë (II) : "Gjithashtu Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson edhe kërkesën tjetër të njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit ku si kërkesë, ka qenë kërkesa me nr 3, Autoriteti Kontraktues-(AK) Ministria e Mjedisit, Planifikimi Hapësinor dhe Infrastrukturës e ka rekomanduar për kontratë një Operator ekonomik i cili është i papërgjegjshëm për faktin se i njëjti nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, përkatësisht Kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 te kërkesës me nr 2. Kapaciteti teknik dhe profesional Kërkesa nr.2: 2. OE-ik duhet te ofroj dëshmi për stafin profesional dhe atë si vijon; • (3 punëtorë) Automekanik Dëshmia e kërkuar dokumentare; 2. Si dëshmi duhet dorëzuar kontratën për marrëdhënie pune apo para kontratën duke specifikuar titullin e projektit ne fjale dhe kohen, kopjet e diplomave të noterizuara të shkollës se mesme. Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën e lartcekur, për faktin se i njëjti në lidhje me kërkesën e lartcekur ka prezentuar në ofertë si punëtor Automekanik z.Fatmir Mehmeti, dhe z. Armed Gashi, me të cilin ka lidhë kontratë, të njëjtit i ka prezantuar edhe me diploma te shkollës se mesëm, por nuk e ka prezantuar diplomën e punëtoreve t të noterizuar,

Pretendimi i tretë (III) : " Ne njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit te Kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2, Kapaciteti teknik dhe profesional Kërkesa nr: 6, është kërkuar; Kapaciteti teknik dhe profesional: 6. OE të jetë i certifikuar me ISO 9001 2015 – Menaxhimi i Cilësisë për shërbimet e Servisimit . Dëshmia e kërkuar dokumentare: Dëshmi 6. OE duhet të dëshmoj kopje të Certifikatës të noterizuara nga origjinali ISO 9001-2015 të akredituar në Menaxhim të Cilësisë për shërbimet e Servismit. Dëshmia e kërkesës me nr: 6. ka qenë kopje të Certifikatës të noterizuara nga origjinali, operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka prezantuar Certifikatën ISO 9001:2015. Certifikata është me nr : SISTEMA/KOS/0322QNE251, e lëshuar me datë 26.03.2021 me vlefshmëri deri në 25.03.2024, por certifikata ISO 9001:2015 e prezantuar nga ana e operatorit ekonomik i rekomanduar për kontrata nuk është e notarizuar nga ana e noterit, certificata ISO 9001:2015 e lëshuar për në emër te ''N.T.SH. EUROPA'' nuk përmban deklaratën e noterit, ose vërtetimin nga origjinali ne kopje. Pra shihet shumë qarte se vlerësimi i këti aktiviteti te prokurimi nuk është vlerësuar konform LPP-së, shihet autoriteti kontraktues nuk ka vepruar konform kërkesave te njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit, te kërkesat mundësit teknike dhe ose profesionale te kërkesa me nr 6, si dëshmi dokumentare kërkon notarizimin dhe vërtetimin e dokumentit nga origjinali në kopje, dhe kriterin e vendos vete si Autoritet kontraktues nuk e respekton, e rekomandon operatorin ekonomik i cili ka dorëzuar certifikatën ISO te pa notarizuar.

Pretendimi i katërt (IV) : "Gjithashtu Autoriteti Kontraktues-(AK) Ministria e Mjedisit, Planifikimi Hapësinor dhe Infrastrukturës e ka rekomanduar për kontratë Operatorin ekonomik i cili është i papërgjegjshëm për faktin se i njëjti nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, përkatësisht Kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2, Kapaciteti teknik dhe profesional Kërkesa nr: 8. Kapaciteti teknik dhe profesional: Kërkesa me nr: 8. OE duhet të ketë hapësirën e objektit–ve minimum 300 m2; Dëshmia e kërkuar dokumentare: Dëshmia e kërkuar e kërkesës me nr: 8. Hapësira e objekteve (serviseve) minimum duhet të jetë 300 m2, dëshmi mbi pronësinë (apo të marrjes me qira të

objektit -servisit). Nëse objekti - punëtoria është në pronësi si dëshmi kërkohen kopjet e dokumentacionit të pronësisë. Nëse objekti - punëtoria është marr me qira si dëshmi kërkohet kopja e kontratës së qeras e noterizuar. Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka prezantuar në këtë aktivitet te prokurimit një kontratë mbi qiranë. Ka prezantuar kontratën me numër, LRP Nr. Rend. 12119/2021, Nr.Ref.1492/2021. Kontrata është e lidhur me datën 11.08.2021. ndërmjet z.Hajriz (Kamer) Murturi, si qiradhënës, dhe Bastri Ademi B.I-N.T.SH ''EUROPA'', si qiramarrës. Në kontratën e prezantuar nga operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë, është Parcel-tokë, nuk është objekt siq është kërkuar nga ana e autoritetiti kontraktues, pra operatori ekonomik nuk ka prezantuar kontratë mbi qiranë për objektin/servisin për servisimin e automjeteve, por i njëjti operator ekonomik posedon një kontratë mbi qiranë për një parcela tokë.

Pretendimi i pestë (V) : "Po ashtu Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka vendosur çmime manipulative tek përshkrimi i çmimit, te automjeti Reno Talisman 2.0 viti 2019, Pjesa e parë Servisimet e rregullta pozicioni me nr: 5. Filtrin e naftës ka vendosur çmime 55.00 Euro. Te pjesa e dyt, Mirëmbajtja dhe Ndërrimi i Pjesët Rezervë - përshkrimi i artikujve, pozicioni me nr; 108. Mbushja e klimes, operatori ekonomik ka vendosur çmime 250.00 euro. Në pozicionin me nr; 187. Syri i farit operatori ekonomik ka vendosur çmime 65.00 euro. Në pozicionin me nr; 198. Vaj ndërruesi operatori ekonomik ka vendosur çmime 28.00 euro për litër. Te automjeti Audi A 4, 1.9cm3,viti 2019, te përshkrimi i çmimit pjesa e para Servisimet e rregullta, pozicionin me nr: 5. Filtrin e naftës ka vendosur çmime 55.00 Euro. Te pjesa e dytë, Mirëmbajtja dhe Ndërrimi i Pjesët Rezervë - përshkrimi i artikujve, pozicioni me nr; 108. Mbushja e klimës, operatori ekonomik ka vendosur çmime 250.00 euro. Në pozicionin me nr; 127. Pllakat e frenimit (para) ka vendosur çmime 175.00 Euro. Në pozicionin me nr; 187. Syri i farit ka vendosur çmime 145.00 Euro. Në pozicionin me nr; 198. Vaj ndërruesi operatori ekonomik ka vendosur çmime 28.00 euro për 1 litër. Në pozicionin me nr: 231. Boshpumpa ka vendosur çmime 1.00 Euro. Te automjeti VW Amarok 1.9 cm3 viti 2023, te përshkrimi i çmimit pjesa e para Servisimet e rregullta, pozicionin me nr: 5. Filtrin e naftës ka vendosur çmime 56.00 Euro. Te pjesa e dyt, Mirëmbajtja dhe Ndërrimi i Pjesët Rezervë - përshkrimi i artikujve, pozicioni me nr; 108. Mbushja e klimës, operatori ekonomik ka vendosur çmime 250.00 euro. Në pozicionin me nr; 127. Pllakat e frenimit (para) ka vendosur çmime 185.00 Euro. Në pozicionin me nr; 187. Syri i farit ka vendosur çmime 145.00 Euro. Në pozicionin me nr; 198. Vaj ndërruesi operatori ekonomik ka vendosur çmime 28.00 euro për 1 litër. .Nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët siq parashihet edhe ne nenin 60 paragrafi 1.1 i LPP-së sepse është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik i papërgjegjshëm, e që në këtë rastë është rekomanduar një Operator ekonomik i papërgjegjshëm e i cili e ka me te sigurt se nuk do të ketë në dispozicion kapacitete teknike dhe profesionale për të impletu kontratën në tersi.Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Nenin 1, 6, 7, 59, 60, 69 të LPP-së, si dhe nenin 4, 40, 41 të RRUOPP-së si dhe Rregullat për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese dhe Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët B57. Duke u bazuar në të gjitha provat, dëshmitë dhe faktet që u përmendën më lartë, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit qe te nxjerr këtë: Vendim qe te Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE-së Gani B. Krasniqi B.I -D.P.Z ''Suzuki'', Anulohet, njoftimi dhe vendimi B58 i Autoriteti Kontraktues për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare të MMPHI-së dhe lënda kthehet në Rivlerësim. Detyrohet Autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe

krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dizpozitave të LPP-së.

Autoriteti kontraktues përgjigje ne Kërkesën për rishqyrtim te OE ankues.

Sa i parkete pretendimit I ankimor OE ekonomik i rekomanduar për kontrate ka ofertar me Automjet për transportimin e automjeteve duke e dëshmuar me Librezë te automjeti te regjistruar dhe valid me targa 01-891-EA duke ofertuar konform kritereve te dosjes se tenderit. Ne dosje le tenderi është kërkuar : Kërkesa mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9,2 Kapaciteti teknik dhe profesional: Operatori Ekonomik duhet të posedoje mjete, stabilimentet dhe pajisjes teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit a. Vinqa Hidraulik për ngritje te automjeteve minimum 5 cope b. paisje për mbushjen e klimave minimum 1 copë. Pajise për diagnoztifikimin e automjeteve minimum / cope. d. Automjet për transportimin e automjeteve minimumi / cope Dëshmia e kërkuar dokumentare 3. Dëshmi me foto apo ndonjë dokument tjeter dëshmues (apo te marrjes me qira te mjeteve duhet të jene - Deklaratat unike doganore - DUD. foto apo ndonjë fature për blerjen e tyre, ndërsa për automjetet qe janë ne lëvizje për bartjen e automjeteve ato te dëshmohen me libreza te qarkullimit de automjeteve valide. Pra nën d është kërkuar Automjet për transportimin e automjeteve minimum / cop dhe dëshmia e kërkuar dokumentare ka qene te dëshmohet me libreza te qarkullimit te automjeteve valide. OE i rekomanduar për kontrate ka ofertuar me Librezë te automjetit te regjistruar dhe valid me targa 01-891-EA duke ofertuar konform kritereve te dosjes se tenderit. Pra ne dosje te tenderit askund nuk eshë kërkuar qe automjeti transportues te këtë ne kubikash te caktuar. Për këtë është komisioni i vlerësimit ka vlerësuar se OE ka ofertuar konform kësaj pike. Është përgjegjësi e OE i cili nënshkruar kontratën ta boj transportimin e automjete në rast defekti konform dosje së tenderit. Është përgjegjësi e Policisë së trafikut te Rep. se Kosovës se si do ti barte veturat a janë konform ligjeve në fugi apo jo. Ne rastin konkret OE i rekomanduar për kontrate ka ofertuar konform kritereve te dosjes se tenderit. Gjithashtu OE i rekomanduar për kontrate në ofertën tij ka deklaruar se do ti përmbahet ne tërësi dosjes se tenderit konform specifikimeve teknike. Si përfundim ky pretendim ankimor është i pa bazuar. Përgjigja nr.2: Sa i për ketë pretendimit 2 ankimor AK-ja ka versuar dhe konstatuar qe OE i rekomanduar për kontrate ka ofertuar konform dosjes së tenderit ashtu siç është kërkuar. Ne dosje te tenderit është kërkuar Kërkesa mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2. OE-ik duhet te ofroj dëshmi për stafin profesional dhe atë si vijon: (3 punëtore) Automekanik Dëshmia e kërkuar dokumentare: 2. Si dëshmi duhet dorëzuar kontratën për marrëdhënie pune apo para kontratën duke specifikuar titullin e projektit ne fjale dhe kohen, kopjet e diplomave te noterizuara te shkollës se mesme. OE i rekomanduar për kontrate ka ofertuar me kontrata të punës valide për AUTOMEKANIK ne këtë rast Kontratat nuk janë kërkuar te noterizune por janë kërkuar parakontrata nëse paraprakisht OE ofertues do ti angazhojn ne këtë projekt. Sa i përketë diplomave të punëtoreve ato komisioni i vlerësimit i ka konstatuar qe i kane lëshuar Institucionet Publike te Republikës se Kosovës dhe kjo shume lehte dhe shpejt edhe mund le verifikohet në shkollat përkatëse.Megjithatë këto diploma janë te noterizuara dhe te vërtetuara konform ligjeve te aplikueshme për noterin.

Megjithatë ka vendime të OSHP-se me te cilat nuk qon fare pesh noterizimi i diplomave atëherë kur është lehte e verifikueshme sidomos kur i kane lëshuar Institucionet e Rep. së Kosovës. Ky pretendim ankimor është i pa bazuar. Përgjigja nr.3: Sa i parkete pretendimit 3 ankimor OE ka ofertuar me certifikatë ISO 9001:2015 e cila ka linkun për verifikim dhe e cila është valide që nga 26.03.2021. OE ka ofertuar me këtë certifikatë te skenuar nga origjinali. AK-ja ka kërkuar me 27.11.2023 nga OE që ta dorëzoj te noterizuar certifikatën. OE ka dozuar një deklarate ne e-prokurim me 29.11.2023 ku deklaron qe certifikata është valide e cila mund të verifikohet online gjithashtu ka bashkangjitur edhe verifikimin. Gjithashtu origjinalin e certifikatës e ka prezantuar ne Autoritetin Kontraktues dhe të noterizuar me 29.11.2023.AK-ja ka pranuar dëshmitë e OE konform nenit 72 te LPP-së. Pretendimi ankimor është i pa bazuar. Përgjigja nr.4 : Sa i parkete pretendimi 3 ankimor OE i rekomanduar për kontrate ka ofertuar me kontrate qerase te noterizuer duke bashkëngjisë ethe dëshminë për largësinë e servisit te kompanisë e cila është 1.8

km nga objekt i MMPHL Komisioni i AK-së gjatë vlerësimit te ofertove ka dal në vendin e objekti te OE ofertues dhe ka konstatuar gjendjen faktike te tre duke vlerësuar qe kane ofertave konform kritereve te dosjes se tenderit OE i rekomanduar për kontrate ka objektin me qera te servisit te kompanisë konform dosjes së tenderit. Është përgjegjësi e individëve apo edhe e Komunës qe mirrën me legalizimin e objekteve se a duhet te legalizohen objektet ne vendet e caktuara apo jo. OE ka dëshmuar ne ofertën e tij se ka përfunduar kontrata me Institucione Publike të Rep. së Kosovës ne atë objekt ku e ka me qera. Si përfundim edhe ky pretendim ankimor është i pa bazuar. Përgjigjja nr.5 Sa i parkete pretendimit ankimor për çmime të larta AK-ja ka versuar qe dallimi ndermet dy OE ofertues nuk është aq i madh. Dallimi me çmim total le peshuar ndërmjet dy OE është 811,96 euro. Duke marr parasysh edhe dallimin e vogël ndërmjet dy OE ofertës AK-ja ka vendosur që mos të kërkoj sqarime shtesë sa i për ketë çmimeve pasi qe komisioni ka hulumtuar çmimet e tregut te veturave përkatëse dhe është konstatuar që çmimet e ofruara nga OE i rekomanduar për kontrate janë çmime reale pra çmime të tregut me një fitim simbolik. Ne këtë rast ju si OE ankues nuk jeni aq serioz ne ankesën e juaj pasi qe pozicioni qe ju pretendoni p.sh. SYTI 1 / FARIT komisioni ka verifikuar se të veturat e modelit të ri qe i posedojnë ne si AK janë çmime reale. Edhe te mbushja e klimës veturat e reja qe i posedojnë ne si AK kemi hulumtuar se veturat e reja freonin (Refrigerant) e kane R 1234 yf qe do të thotë se çmim real.

Duke mos a leshur ne te gjitha pozicionet ku ju pretendoni se OE i rekomanduar për kontratë ka çmime te larta kemi vlerësuar se ju si OE ankues ofertës nuk keni njohuri aq sa duhet për veturat për te cilat ju keni aplikuar. Duke marr parasysh qe ne si AK kemi komisionin për vlerësim dhe verifikim të çdo pjese të veturës ke kemi kërkuar qe pjesët le jene te reja dhe origjinale me garancion kemi hulummar se te gjitha pozicionet kane çmime te tregut. Andaj pretendimi i juaj është i pa bazuar. Ne si AK kemi bërë vlerësimin. Krahasimin, ekzaminimin e ofertave konform menin 59 te LPP-se, koform neni 1 te LPP-se konform nenit 4 dhe 10 1 RRUOP-së konform nenit 6,7,60,69 të LPP-së. Andaj bazuar ne përgjigjet e dhëna nga ana e AK ju njoftojmë se kërkesa juaj aprovohet pjesërisht kërkesa. Andaj, konsiderojmë se Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës- Divizioni i Prokurimit, ka plotësuar te gjitha kriteret e vendosura në dosjen e tenderit, konform Rregullave dhe Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik le Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligin Nr., OS/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, mbi përcaktimin e kritereve në njoftimin për kontrate dhe dosjen e tenderit."

- *Administrimi dhe vlerësimi i provave –*

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 03.01.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1008/23, ndërsa me datë 09.01.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2023/1008 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se Pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtuese, po ashtu edhe OE Nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues

Vlerësimi i eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/1008, të pretendimeve ankimore të OE "Gani B. Krasniqi B.I." ankues, si në vijim;

Sqarim hyrës: “Autoriteti Kontraktues – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapesinor, gjatë këtij aktiviteti ka aplikuar procedurën e hapur, vlerë e madhe, lloji i kontratës shërbime, vlera e parashikuar 200,000.00€. AK me dt 27.09.2023 ka publikuar Njoftimin për kontratë ndërsa hapja e ofertave është bërë me dt 10.11.2023 dhe për këtë aktivitet prokurimi kishin aplikuar vetëm dy operator ekonomik. AK-Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapesinor me dt. 04.12.2023 ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-se ku për kontratë ka rekomanduar Bastri Ademi B.I) vlera e ofertës me poentim 76,003.10€. Ndërsa oferten e OE ankues është vlerësuar si ofertë e pa suksesshme. Kundër njoftimit mbi vendimin e AK, pala fillimisht parashtron kërkesë për Rishqyrtim tek AK me dt 07.12.2023 brenda afatit ligjor. AK me dt. 11.12.2023 nxjerr vendim mbi refuzimin e kërkesës si të pabazuar OE i pakënaqur me përgjigjen e AK-së me dt. 12.12.2023 paraqet ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) me pretendime të njëjta. OE ankues, në ankesë ka paraparë pesë pretendime ankimore, të gjitha pretendimet ankimore kanë të bëjnë me ofertën e rekomanduar për kontratë.”

Konstatimi i parë (I): “Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, sqarojmë se parashtruesi i ankesës në kërkesën për Ri-shqyrtim dhe ankesën e dorëzuar në OSHP, në pretendimin e parë, kundërshton ofertën e OE të rekomanduar për kontratë tek kërkesa e dosjes së tenderit të vendosuar tek kapaciteti teknik dhe profesional apo 9&1 dhe 9&2 saktësisht kërkesën e tretë të saj. OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për ta përmbushur kërken e dosjes së tenderit ka ofertuar me automjet për bartjen e vetuarave të tipit IVECO me peshtë maksimale prej 3510 Kg, kurse tek përshkrimi i cmimit tek pjesa II AK ka përfshirë edhe automjetin e tipit Toyota JTMCV09JX04007699, numër te regjistrimit të tabelave 3Z-171-13, viti i prodhimit 4/3 2009, me Peshe te automjetit 3938 KG. Andaj i njëjti Operator ekonomik nuk e plotëson kërkesën e lartcekur për faktin se në ofertë nuk ka prezantuar kamion adekuat konform cm3 te automjeteve, nuk posedon kamion për bartjen e automjeteve te tipit TOYOTA, mirëpo ka prezantuar një Kamion me peshe maximum te ngarkesës së lejuar prej 3510 KG, e cila peshë është e cekur në certifikatën e regjistrimit te numri rendor (F1). Duke u bazuar nga certifikata e regjistrimit të kamionit te prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë, dhe bazuar në certifikatat e regjistrimit te automjeteve te prodhuesit tipit Toyota del që Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson këtë kërkesë. Eksperti Shqyrtues sqaron se, bazuar në analizën e fakteve/ dëshmive AK në dosje të tenderit për pretendimin e parë të OE ankues kishte kërkuar tek nën pika d. që OE të posedoj “Automjet per transportimin e automjeteve minimumi 1 copë”. Vlenë të ceket fakti se AK për këtë aktivitet të prokurimit kishte pranuar dy kërkesa për sqarime të dosjes së tenderit, por në asnjën prej tyre nuk kishte pyetje sa i përketë kërkeses së dosjes së tenderit të cilën tani OE ankues e ka paraqitur në pretendimin e parë. Kërkesa e 3 tek kapaciteti teknik dhe profesional në dosje të tenderit ka qenë; 3. Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit a. Vinqa Hidraulik per ngritje te automjeteve minimum 5 copë b. paisje per mbushjen e klimave minimum 1 copë c. Paisje per diagnoztifikimin e automjeteve minimum 1 copë. d.Automjet per transportimin e automjeteve minimumi 1 copë. Dëshmia;3. Dëshmi me foto apo ndonjë dokument tjetër dëshmues (apo te marrjes me qira) te mjeteve duhet te jene - Deklaratat unike doganore - DUD, foto apo ndonjë fature për blerjen e tyre, ndërsa për automjetet qe janë ne lëvizje për bartjen e automjeteve ato te dëshmohen me libreza te qarkullimit te automjeteve valide. Eksperti Shqyrtues sqaron se, bazuar në kërkesen e dosjes së tenderit, askund nuk është kufizuar pesha e automjetit për transportimin e automjeteve, ashtu siç pretendon tani OE ankues. Bazuar në nenin 56 paragrafi 3 i LPP-së, OE nuk mund te diskualifikohet nga procedura e prokurimit për një kriter i cili nuk ka qenë i paraparë në njoftim për kontratë dhe dosje te tenderit. Neni 56 pargrafi 3 i LPP-së “Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”. Përveç kësaj edhe neni 59 paragrafi 4 i LPP-se, një ofertë e konsideron te përgjegjshme vetëm atëherë kur ajo është në përputhje me kriteret e parapara në njoftim për kontratë dhe dosje të tenderit. Nenin 59 paragrafi 4 i LPP-se “Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”. Si përfundim sa i përketë pretendimit të parë të OE ankues, konsideroj se është i paqëndrueshëm për faktin se askund ne dosje të

tenderit dhe njoftimit për kontratë nuk është kufizuar pesha e bartjes së automjetit transportues të automjeteve, siç pretendon tani OE ankues. Andaj, vlerësojmë se pretendimi i parë është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e dytë, se OE i rekomanduar për kontratë nuk e përmbushë as kërkesën e dytë të dosjes së tenderit tek kapaciteti teknik dhe profesional e cila ka qenë; Kërkesa nr.2 OE-ik duhet te ofroj dëshmi për stafin profesional dhe atë si vijon; • (3 punëtorë) Automekanik Dëshmia; 2. Si dëshmi duhet dorëzuar kontratën për marrëdhënie pune apo parakontraten duke specifikuar titullin e projektit ne fjale dhe kohen, kopjet e diplomave të noterizuara të shkollës se mesme. Eksperti Shqyrtues sqaron se, bazuar në analizën e fakteve në platëformën elektronike E-prokurimi, tafit me gjithësej 5 punëtor prej tyre tre automekanik, një autoelektrecist, një autollaker. Për stafin kishte dorëzuar kopjet e diplomave të noterizuara, kontratat e punës dhe CV-të. Sa i përketë pretendimit se OE i rekomanduar për kontratë për punënorët Fatmir Mehmeti dhe Armend Gashi, se nuk ka dorëzuar diploma të noterizuara, për shkak se në vulat e noterit askund nuk ceket se janë të noterizuara diplomat. Vlenë të ceket se OE ka dorëzuar diploma të lëshuara nga Ministria e Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës, së bashku me noterizim të dokumnetit por që në vulën e noterit ceket fakti se z. Armend Gashi, i identifikuar përmes numerit personal ka noterizuar dokumentit prej dy faqeve, por në shabllonin e noterit Skender Dumani nga Podujeva askund nuk ceket emri i dokumentit. Nëse e shiqojmë diplomën e bashkangjitur nga z. Armend Gashi, vërehet edhe vula e noterit në qoshet e diplomës se dorëzuar, çka nënkupton se diploma në fjalë është e noterizuar nga origjinali. Shih si provë vulën e noterit dhe pjesën e diplomës. Eksperti shqyrtues sqaron se në të dy faqet e diplomave në qoshet e saj lartë vërehet edhe vula e noterit, si copës e vogël dhe në fund të fletës komplet vula e dhënë nga noteri, andaj mbi këtë bazë komisderoj se komisioni i vlerësimit ka vepruar konform nenit 59 paragrafi 4 i LPP-se pasi që OE i rekomanduar për kontratë e ka përmbushur në tërësi kërkesën e dosjes së tenderit sa i përketë stafit profesional të kërkuar në dosje të tenderit. Prandaj, në përputhje me konstatimet e mësipërme vlerësojmë se pretendimi i dytë i palës në ankesë është i pabazuar.

Më tej, OE ankues në pretendimin e tretë, potencon faktin se OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka përmbush as kërkesën e 6 të paraparë tek kërkesa e dosjes se tenderit 9&1 dhe 9&2 tek kapacitetit teknik dhe profesional e që është; Kapaciteti teknik dhe profesional: 6. OE të jetë i certifikuar me ISO 9001 2015 – Menaxhimi i Cilësisë për shërbimet e Servisimit . Dëshmia e kërkuar dokumentare: Dëshmi 6. OE duhet të dëshmoj kopje të Certifikatës të noterizuara nga origjinali ISO 9001-2015 të akredituar në Menaxhim të Cilësisë për shërbimet e Servismit. Eksperti Shqyrtues sqaron se, bazuar në analizën e fakteve në platëformën elektronike E-prokurimi, OE i rekomanduar për kontratë për ta përmbushur kërkesën e dosjes së tenderit kishte dorëzuar Certifikaten ISO 9001 20215 por që ishte e pa noterizuar. AK, me dt 27.11.2023 konform nenit 72 të LPP-së kishte kërkuar sqarime shtesë nga OE i rekomanduar për kontratë, lidhur me atë se në dosje është kërkuar që të dorëzohet certifikata ISO e noterizuar nga origjinali ndërsa ju keni dorëzuar vetëm certifikatën e pa noterizuar. OE me dt 29.11.2023 kishte kthyer përgjigje duke e njoftuar AK-në se ka dorëzuar certifikatën origjinale dhe njëkohësisht në kopje fizike origjinalin e kishte dorëzuar tek AK për verifikim, poashtu kishte bashkangjitur edhe linkun për verifikim. Në cilësinë e ekspertit shqyrtues, për ta qartësuar pretendimin e palës ankuese, e kam verifikuar përmes linkut www.sistemacerts.com certifikaten e dorëzuar nga OE i rekomanduar, dhe vërehet se OE në fjalë posedon certifikatën ISO 9001-2025 valide deri me 26.02.2025. provë verifkimi nga faqja zyrtare. Siç vërehet nga ajo që është cekur më lartë, OE i rekomanduar është fakt se ka dorëzuar certifikate të pa-noterizuar me ofertë, por nga dëshmitë lehtë të verifikueshme, vërehet se i njëjti e posedon certifikatën ISO 9001 2015 – Menaxhimi i Cilësisë për shërbimet e Servisimit, konform kërkesës së dosjes së tenderit dhe si i tillë është i

përgjegjshëm për këtë pikë ankimore. Prandaj, në përputhje me konstatimet e mësipërme vlerësojmë se pretendimi i tretë i palës në ankesë është i paqëndrueshëm.

Lidhur me pretendimin e katërt të OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë nuk posedon objekt prej 300m² konform kërkesës së dosjes së tenderit për faktin se ka dorëzuar një kontratë për marrje me qira të parcelës e cila sipas regjistrit kadastral figuron tokë dhe jo objekt afarist. Eksperti Shqyrtues sqaron se, bazuar në analizën e fakteve në platformën elektronike E-prokurimi, por edhe në provat që ka bashkangjitur OE ankues nga Agjencia kadastrale për këtë pikë vërehet se, në atë parcelë është i ndërtuar një objekt, kurse bazuar në vendimin e AK-së për refuzimin e kërkesës për Rishqyrtim AK ka potencuar faktin se; Komisioni i AK-së, gjatë vlerësimit të ofertave ka dalë në vend të ngjarjes dhe ka konstatuar se OE i rekomanduar për kontratë posedon me qira objektin afarist konform kërkesave të dosjes së tenderit. Po ashtu AK ka potencuar faktin se objekti i ndërtuar në parcelën e atakuar me ankese nga OE ankues, nuk është i legalizuar por që OE ka ofruar dëshmi të mjaftueshme, se ushtron veprimtarinë si Automekanik ne objektin e njëjtë dhe po ashtu që ka realizuar dhe realizon kontrata me institucione të ndryshme të republikës së Kosovës në të njëjtin objekt afarist. Eksperti Shqyrtues sqaron se, AK, e ka verifikuar gjendjen faktike përmes vizitës së komisionit vlerësues tek selia e OE të rekomanduar dhe ka konstatuar se ekziston objekti afarist i ndërtuar ne parcelën kadastrale me nr. P-71914059-00178-6,e cila është pjesë e kontratës së qirasë në mes të OE të rekoamnduar dhe pronarit të parcelës me nr. P-71914059-00178-6, në të cilën është i ndërtuar objekti afarist. Më tej, eksperti shqyrtues sqaron se, pretendimi i palës në ankesë se parcela me nr. P-71914059-00178-6, nga njësia kadastrale është livadh, nuk qëndron për faktin se gjendja faktike e dëshmon çartë edhe nga dëshmitë e bashkangjitura nga vet OE ankues, se në parcelën e lartcekur është i ndërtuar objekti afarist. Prandaj, në përputhje me konstatimet e mësipërme vlerësojmë se pretendimi i katërt i palës në ankesë, se OE i rekomanduar nuk posedon objekt afarist por qe parcela është vetëm livadh/tokë është i paqëndrueshëm.

Lidhur me pretendimin e pestë se OE i rekomanduar ka ofertuar me çmime manipulative dhe jonormalisht të Ulëta, është pak befasues kjo për faktin për këtë aktivitet të prokurimit kishin aplikuar vetëm dy operatorë ekonomik me një dallim në çmimin total të poentuar në vlerë prej 811.96€. Përveç kësaj OE ankues edhe bazën ligjor për këtë pretendim ankimor e ka bërë gabimisht duke u thirrur në dokumente të fuqizuara siç janë RROUPP-ja dhe rregullat B57 për tenderë jo normalisht të ulët. Vlenë të ceket fakti se dokumentet e larte cekuar janë shfuqizuar nga KRPP-ja me dt. 01.11.2022 kur ka hyrë në fuqi rregullorja për prokurim publik me numër 001/22. Eksperti Shqyrtues sqaron se, bazuar në analizën e fakteve/ dëshmive të dokumentuara në platformën elektronike E-prokurimi, përkundër faktit se OE bazën ligjore në ankesë e ka paraqitur gabim, nuk ishte përmbushur asnjë kriter që oferta e OE të rekomanduar për kontratë të trajtohet si ofertë jo-normalisht e ulët. Kjo për faktin se për këtë aktivitet te prokurimit bazuar në procesverbalin e hapjes së ofertave kishin marr pjese gjithsej 2 oferta me një diferencë prej 811.96€ në total të çmimit total të poentuar. Sipas nenit 41.3 te rregullores 001/2022 për prokurim publik; Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme : i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm; ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët; iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë. Bazuar në të cekurat me lartë, vlerësoj se nuk ishin përmbushur kriteret e parapara në neni 41.3 te rregullores me nr. 001/2022 për prokurim publik, që oferta e OE të rekomanduar për kontratë të trajtohet si tender jo-normalisht i ulët apo me çmime manipulative për faktin se të dy ofertat e dorëzuara kanë një diferencë të vogël në vlerë prej 811.96 Euro. Andaj , vlerësojmë edhe në këtë pikë pretendimet e

palës në ankesë nuk janë të qëndrueshme.”

- *Gjetjet e Panelit Shqyrtues –*

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në ketë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e Operatorit Ekonomik ankues, raporti është bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit, sipas të cilit pretendimet ankimore të Operatorit Ekonomik ankues, janë vlerësuar ligjërisht si të pabazuara.

Paneli Shqyrtues bazuar në të gjeturat e ekspertit shqyrtues, konsideron se ankuesi nuk ka arritur të dëshmoj me prova konkrete se ka pasur shkelje ligjore nga ana e Autoritetit Kontraktues gjatë zhvillimit të aktivitetit të prokurimit në fjalë. Andaj Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare te MMPHI-se (ish MMPH)” me nr. të prokurimit: "210-23-10358-2-1-1". Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të refuzuar ankesën e Operatorit Ekonomik e “Gani B. Krasniqi B.I.” dhe ka Vërtetuar Vendimin e AK -B58 me te cilin Autoritetit Kontraktues, lidhur me aktivitetin e prokurimit, ka shpërblyer me kontrate “Bastri Ademi “B.I”

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e refuzimit të ankese të OE, vendosi të konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP, ndërsa mjetet të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar ”Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha

aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj" lidhur me nenin 59,1 cituar "Autoriteti kontraktues do të themeloi një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës"

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, dhe nenin 105 nenin të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor**
- OE - **Gani B. Krasniqi B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: